



Forumi për Iniciativa Qytetare

1 Qvite!



RAPORT VJETOR

2010

Për FIQ-in

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare, e përqëndruar në sundim të ligjit, që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar, ku mbretëron paqa dhe drejtësia.

FIQ angazhohet për transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë dhe forcimin e kapacitetit të shoqërisë civile për të qenë akterë aktiv dhe i qëndrueshëm në ushtrimin e rolit të vet mbikqyrës.

FIQ e bënë këtë përmes studimeve dhe analizave, diskutimeve, trajnimit dhe dhënies së granteve.

Letra nga Drejtori Ekzekutiv

Të nderuar lexues, kam kënaqësinë të ju drejtohem me pak fjalë për të reflektuar në punën e FIQ për vitin që lamë pas.

Viti 2010 ishte vit historik për FIQ, ngase në këtë vit, ne shenuam dhjetëvjetorin e themelimit! Këtë vit, në kremtuam dhjetë vite punë të suksesshme dhe me sfida, e mbi të gjitha dhjetë vite kontribut në rrugën tonë të përbashkët të shtetkrijimit dhe ndërtimit të paqes dhe demokracisë në Kosovë.



FIQ përgjatë tërë këtyre viteve, mbeti akter kredibil dhe i respektueshëm në familjen e shoqërisë civile dhe shoqërisë në përgjithësi, si dhe zë kritik i mbrojtjes së interesit publik.

Gjatë këtij viti, FIQ arriti që Çmimin FIDES për Filantropi ta bëjë tashmë traditë në Kosovë, duke i dhënë kështu një hapësirë të veçantë promovimit të kontributit të çmueshëm të biznesit kosovar. Ndërsa, e veçanta e Çmimit FIDES ishte ndarja e Çmimit për Filantropi me emrin e humanistit tonë të madh Anton Çetta.

Për të rritur edhe më shume ndikimin tonë në punën tonë në fushën e sigurisë, pra ndikimin tonë në krijimin e politikave qeveritare, ne gjatë këtij viti, në bashkëpunim me partner të tjerë, krijuam Forumin për Siguri - një platformë diskutimi në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve vendore e ndërkombëtare për çështjet e rëndësishme të sektorit të sigurisë në Kosovë. Forumi për Siguri me studimet e veta tashmë ka dëshmuar të jetë trup me ndikim në politikat e sigurisë dhe veprimet e institucioneve përkatëse të sigurisë në Kosovë.

Gjatë këtij viti, krahu i granteve në FIQ vazhdoi zgjerimin e vet dhe ne arritëm që të mbështesim nisma të orgnaizatave joqeveritare të cilat adresuan problemet mjedisore; përmirësimin e cilësisë së jetesës, si dhe mobilizimin qytetar për të rritë nivelin e pjesëmarrësve në zgjedhjet e fundit.

Dëshiroj të përmbyllë këtë refleksim timin në punën e FIQ duke falenderuar bashkëpunëtorët dhe donatorët tonë që çdo herë na qëndrojnë afër, si dhe të gjithë ata që në një formë apo tjetrën ishin pjesë e aktiviteteve tona gjatë vitit 2010.

Sinqerisht,
Ferdinand Nikolla

SUNDIMI I LIGJIT

Programi për Sundim të Ligjit përqëndrohet në fushën e sigurisë dhe drejtësisë dhe ka për qëllim zhvillimin dhe forcimin e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në shërbim të qytetarëve. FIQ mëton të arrijë këtë përmes studimeve dhe analizave lidhur me zbatimin e politikave të sigurisë dhe drejtësisë, nxitjen e qytetarëve për të formësuar këto politika, inkurajimin e bashkësisë për përmirësimin e infrastrukturës ligjore në nivel lokal, si dhe ndikimin në hartimin e këtyre politikave. Për më shumë, FIQ avokon tek institucionet për qasje në drejtësi në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.

1. Rritja e mbikëqyrjes publike në sundim të ligjit

FIQ në bashkëpunim me shtatë organizata tjera jo-qeveritare partnere, me të cilat punon që nga viti 2007, ka realizuar gjatë këtij viti projektin Rritja e mbikëqyrjes publike në sundimin e ligjit në Kosovë, financuar nga National Endowment for Democracy (NED) dhe Balkan Trust for Democracy (BTD). Qëllimi i këtij projekti ka qenë të ndikoj në funksionalizimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe të përfshij qytetarët në vlerësimin e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë. Ky projekt është përqëndruar në dy fusha: sigurinë dhe drejtësinë. Nga fusha e sigurisë janë trajtuar rritja e kapaciteteve të policisë së Kosovës në hetim të trafikimit me njerëz si dhe hetim të krimeve ekonomike dhe korrupsionit. Ndërsa, në fushën e drejtësisë projekti është përqëndruar në qasjen në drejtësi, përkatësisht funksionimi i zyrave ndërlidhëse të gjykatave, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e drejtësisë.



Informimi i Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian (KIE)

Të dhënat nga fushat e mësipërme i janë përcjellur KIE. FIQ dhe partnerët i kanë dërguar dy raporte Komisionit me qëllim të informimit për zbatimin e PVPE. Këto raporte kanë identifikuar ngetje të madhe në zbatimin e politikave të parapara. Dërgimi i raporteve ka pasur për qëllim që të ofroj të dhëna alternative për Komisionin, si dhe të rrisë llogaridhënien e ekzekutivit ndaj legjislativit. Këto raporte janë konsideruar të rëndësishme për Komisionin për të shtuar mbikëqyrjen e nevojshme ndaj ekzekutivit në çështjet e trajtuara.



Në pesë regjione dhe një komunë (Gjakovë) janë organizuar tri seri debatesh në kuadër të këtij projekti. Luftimi i trafikimit me njerëz është proces që përfshinë shumë institucione si policia, shkolla, Qendra për Punë Sociale etj. Përveç këtyre institucioneve, edhe përshtypja e qytetarëve ka qenë e rëndësishme. Me këtë rast institucionet e Kosovës për së afërmi kanë ndjekë vlerësimin që qytetarët kanë bërë për punën e tyre. Seri tjetër e debateve ka qenë bashkëpunimi i qytetarëve me policinë. Ky debat është paraprirë nga një anketë me 900 qytetarë lidhur me praninë e korrupsionit në polici, duke rezultuar që vetëm 4% e këtyre qytetarëve u kanë dhënë të holla (mito) policisë. Megjithatë, është shqetësues fakti që 26% e të anketuarve kanë arritur të evitojnë ndëshkimin nga ligji si rezultat i njohjeve që kanë pasur në polici. Këto përvoja të qytetarëve më shumë kanë qenë të lidhura me policinë e trafikut. Ndërkaq, në debat qytetarë të shumtë kanë shprehur brengën e tyre për bashkëpunimin me policinë, sidomos sa i përket procedurave të komunikimit. Poashtu, Policia e Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve për bashkëpunim më të madh. Seria e tretë e debateve ka pasur cak fëmijët lëmshëkërkuës si viktima potenciale të trafikimit.

Në të gjitha debatet është theksuar paaftësia e institucioneve komunale dhe qendrore për të siguruar të drejtat e këtyre fëmijëve siç kërkohet në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, ku theksohet detyra e çdo prindi të siguroj zhvillimin fizik dhe mental të fëmijut. Nëse ky kod nuk respektohet, atëherë institucionet duhet të marrin përgjegjësinë për atë fëmijë, gjë e cila nuk është duke ndodhur.

Zhvillimi i hulumtimeve përmes anketave të ndryshme ka qenë poashtu formë e marrjes së mendimeve të qytetarëve. Shembull, Zyrat Ndërlidhëse të Gjykatave

kanë për qëllim lehtësimin e qasjes në drejtësi për minoritetet, edhe pse në të njëjtin vendbanim shumica e tyre kanë shprehur mosinformim për këto zyra. Interesimi i mediave ka qenë në nivel të madh, duke mundësuar transmetimin e të gjeturave të projektit tek numër i madh i qytetarëve.

Publikimi i raportit “Sundimi i ligjit: kapacitetet dhe funksionimi i institucioneve”



Në këtë raport shtjellohen këto tema: në fushën e sigurisë trajtohen rritja e kapaciteteve të policisë në luftimin e trafikimit me njerëz dhe krimi ekonomik dhe korrupsioni. Ndërsa, nga fusha e drejtësisë vlerësohet funksionimi i zyrave ndërlidhëse të gjykatave dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në drejtësi. Qëndrimi kryesor është se përkundër progresit të lehtë, sundimi i ligjit në këto fusha nuk ka qenë prioritet për institucionet e vendit. Në tryezën e organizuar me rastin e publikimit interesimi ishte i lartë, duke pasur vlerësime të ndryshme për funksionimin e këtyre institucioneve.

FORUMI për SIGURI

Në kuadër të projektit Vendi i Sigurtë, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), në qeshor të vitit 2010 kanë themeluar Forumin për Siguri (FS), mbështetur nga Saferworld si pjesë e programit “Vendi i Sigurtë”, financuar nga qeveria gjermane dhe britanike. Forumi për Siguri ka për qëllim të shërbejë si platformë e diskutimit në mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve. Me këtë mëtohet të nxitet komunikimi dhe studimi i duhur i politikave të sigurisë, duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e saj.

Më datën 15 tetor 2010, në ambientet e Hotelit Grand në Prishtinë, u mbajt tryeza me titull **“Sektori i sigurisë në Kosovë pas pavarësisë”**. Është kjo tryeza e parë e organizuar në kuadër të Forumit të Sigurisë. Veç diskutimeve tjera, në këtë tryezë u publikua edhe studimi me të njëjtin titull, i cili jep një vështrim të shkurtër lidhur me të arriturat dhe sfidat e institucioneve të sigurisë në vend, pas shpalljes së pavarësisë.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin përfaqësues të lartë institucional të Kosovës dhe atyre ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe studentë.

Më 21 dhjetor 2010 është mbajtur konferenca e dytë e Forumit për Siguri në ambientet e Hotelit Grand në Prishtinë. Fillimisht është prezantuar raporti vlerësues (një studim kualitativ), me temën: **“Menaxhimi i integruar i kufirit në Kosovë”**, hartuar nga FIQ dhe QKSS.

Raporti ngritë disa dilema lidhur me aspektet kyçe që i karakterizojnë vështirësitë në menaxhimin e integruar të kufirit. Nga aspekti politik, demarkacioni i kufirit dhe bartja e përgjegjësisë nga institucionet ndërkombëtare tek autoritetet kombëtare, është duke zgjatur shumë. Në aspektin teknik, raporti thekson mungesën e mjeteve teknologjike dhe investime të varura nga donatorët.

Panelistë në këtë konferencë ishin përfaqësues të institucioneve të Kosovës si: z. Reshat Maliqi, Drejtor i Policisë së Kosovës, z. Bekim Mehmeti nga Dogana e Kosovës, z. Artan Duraku nga Ministria e Punëve të Brendshme, etj. Ndërsa, në tryezë morën pjesë edhe rreth 40 pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në Kosovë.



DHËNIA E GRANTEVE

Mekanizmi i grantdhënies në FIQ është i organizuar rreth tri fushave programore: Eko, Qytetaria Aktive dhe Ide të Veçanta. Në kuadër të këtyre programeve, FIQ mbështetë financiarisht organizatat joqeveritare, organizatat komunitare, grupet joformale, si dhe rrjetet të cilët mëtojnë të kontribuojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë.

Përmes këtyre programeve, FIQ ka për qëllim të ngrisë nivelin e angazhimit të qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së jetesës, duke krijuar kështu komunitete të qëndrueshme, mjedis të pastër dhe partneritet të frytshëm mes komunitetit, shoqërisë civile, sektorit të biznesit dhe institucioneve të Kosovës.

Gjatë vitit 2010, FIQ ka mbështetur projekte që kanë mobilizuar komunitetin në ruajtjen e mjedisit, avokimin tek institucionet komunale dhe qendrore, si dhe projekte dhe iniciativa që kanë nxitur grupet e ndryshme qytetare për të marrë pjesë në zgjedhjet nacionale të dhjetorit.

Projekti i organizatës “Euro-Ekologët” ka mbledhur qytetarët e disa fshatrave të Pejës për të rritur presionin ndaj institucioneve për degradimin që i është bërë burimit të Drinit të Bardhë nga kyçjet ilegale dhe keqpërdorimet e ujit. Presioni ka shkuar deri në Ministrinë e Mjedisit, për të ruajtur këtë burim të rëndësishëm natyror.



Organizata “Lobi i Studentëve Ulpiana” në Lipjan ka angazhuar nxënësit në pastrimin e mjedisit publik në qytet, pastaj përgatitjen dhe vendosjen e shportave për mbeturina nga vet nxënësit e shkollës teknike. Ndërsa, objektivi tjetër ka qenë avokimi tek Komuna për të ndarë një lokacion për ndërtimin e një parku të qytetit, i cili ka gjetur përkrahjen e institucioneve dhe është ende në proces të realizimit. Poashtu, janë zhvilluar aktivitete teatri nëpër shkolla, me porosinë e ruajtjes së mjedisit.





Në mesin e projekteve që kanë synuar rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje, organizata YIHR ka zhvilluar takime me grupe të fokusuara dhe punëtori me të rinj, për të identifikuar shkaqet e mospjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje. Janë zhvilluar tetë aksione rruge në qytetet më të mëdha të vendit, ku janë zhvilluar bashkëbisedime me qytetarë, të cilëve u është transmetuar edhe porositë e fushatës “Voto se s'bon ndryshe” përmes broshurave dhe posterëve. Është transmetuar edhe një videoklip në televizionet nacionale me porosi të të rinjve për zgjedhjet.



Ndërkaq, iniciativa tjetër e realizuar nga Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan- Programi Hope Fellowship, ka mbledhur dhjetëra aktivistë, të cilët kanë bërë një xhiro njëditore me autobus nëpër Kosovë, duke takuar qytetarë dhe duke u transmetuar porositë që të marrin pjesë në zgjedhje nën moton “Dil dhe voto”.



FILANTROPIA

Festimi i 10 vjetorit të themelimit dhe ndarja e Çmimit FIDES 2010 për filantropi në Kosovë

Viti 2010, ishte viti më i veçantë se asnjëherë më parë për FIQ-in, sepse pikërisht në natën e ndarjes së Çmimit FIDES 2010, i cili tashmë është bërë traditë në Kosovë, FIQ festoi 10 vjetorin e themelimit. 10 vjetori i punës së suksesshme dhe me sfida u festua mes miqësh dhe dashamirësh, në një mjedis tejet të këndshëm, të ngrohtë dhe solemn. Me këtë rast u shfaq edhe dokumentari i titulluar “FIQ 10 vite”, i cili paraqiti aktivitetin e pandalshëm dhjetëvjeçar të FIQ-it që nga dita e parë e themelimit në vitin 2000.



Në po këtë ditë, me 1 dhjetor 2010, FIQ për herë të dytë organizoi festën e madhe të ndarjes së Çmimit FIDES për Filantropi në Kosovë. Ky çmim tradicional, simbolizon mirënjohje të madhe publike për individët dhe biznesin kosovar, të cilët në mënyrë të vazhdueshme dhe të kujdesshme po përkrahin aktivitetet dhe projektet për të mirën e përbashkët.



Duke bërë publik emrat e kompanive, ndërmarrjeve dhe individëve, të cilat kanë përkrahur financiarisht projekte që kanë kontribuar për të mirën e përbashkët të popullit të Kosovës, ky çmim prestigjioz synon të nxisë edhe të tjerët që të ndjekin këtë rrugë, pra të investojnë më shumë në përmirësimin e cilësisë së jetesës në Kosovë.

Veçantia e Çmimit FIDES 2010 u shtua, me faktin se familja e humanistit të madh shqiptar, që një jetë të tërë ia kushtoi afrimit të njerëzve dhe faljes së gjaqeve, të ndjerit Anton Çetta, pa hezitim pranoi që FIQ, çmimin individual për filantropi, ta emërtoj me emrin Çmimi për filantropi “Anton Çetta”. E bija e Anton Çettës, znj. Donika Çetta, para të pranishmëve mbajti një fjalë rasti, ku ndër të tjera u shpreh “Kur jemi pyetur nga FIQ, nëse mund të përdornin emrin e babait tonë për të emërtuar njërin nga çmimet për filantropi, ne me kënaqësi kemi pranuar. Për ne, gjithmonë do të jetë kënaqësi që emri i babait të përdorët si shenjë mirënjohjeje për kontributin e njerëzve që angazhohen për të pasur një jetë më të dinjitetshme të popullit tonë, sepse vet ai bëri të njejtën gjë.”




Në ceremoninë ekskluzive të organizuar më 1 dhjetor, për shpalljen e fituesve të Çmimit FIDES, ishin të pranishëm më se 350 pjesëmarrës. Ndër mysafirët special, që me ca fjalë iu drejtuan të pranishmëve dhe dorëzuan çmimet tek fituesit ishin: z. Haki Abazi – Drejtor i Programit për Ballkanin Perëndimor (RBF), z. Dale Pfeiffer, ish-drejtor i USAID-it në Kosovë dhe Çmimin “Anton Çetta” e ndau znj. Donika Çetta.

Ferdinand Nikolla, drejtor ekzekutiv i FIQ-it, u shpreh: "Kjo festë, sonte, është më e veçantë se asnjëherë, ngase Çmimi FIDES po ndahet në të njëjtën ditë kur FIQ feston edhe 10 vjetorin e vet të themelimit! Për këto 10 vite ne i qëndruam besnik misionit tonë, çdo herë u munduam të jemi të pavarur dhe profesional në punën tonë, duke punuar në bashkëpunim me të tjerët, institucionet, organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, e sidomos me njerëzit tanë nga mbarë Kosova. Ne poashtu, mbetëm zë kritik dhe konstruktiv në aktivitetin tonë, lidhur me proceset e rëndësishme që kaloi Kosova dhe populli ynë gjatë rrugës së shtetndërtimit, zhvillimit dhe paqes në vend".



Çmimi FIDES për kontribut kombëtar e fitoi kompania MERIDIAN Corporation LLC nga Prishtina, kompani kjo e cila ka përkrahur aktivitete me rëndësi shoqërore, aktivitete që reflektojnë pozitivisht, nga të cilat veçojmë përkrahjet në rregullimin e hapësirave shkollore, universitare, aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe aktivitete tjera të rëndësishme.



Çmimi FIDES për kontribut lokal e fitoi kompania Kulla Exim shpk nga Deçani, kompani kjo e cila ka kontribuar në përmirësimin e jetesës në komunën e Deçanit, duke përkrahur aktivitete kulturore, infrastrukturën dhe rininë. Dale Pfeiffer, anëtar i Bordit të Kosovo American Education Fund, me rastin e ndarjes së këtij çmimi, theksoi se “është inkurajuese se si FIQ e ndan çmimin vjetor FIDES, për të njohur publikisht bujarinë e bizneseve në nivel lokal dhe kombëtar.”



Çmimi për Filantropi “Anton Çetta” e fitoi z. Milaim Jashari, person ky i cili themeloi dhe punon vullnetarisht në shoqatën humanitare “Feniks” në Ferizaj, përmes së cilës gjatë pesë viteve ndërtoi 70 shtëpi për të pastrehët, ndërkaq vetëm gjatë vitit 2010 ndërtoi 13 shtëpi.



Qendra e Konferencave të RBF në Pocantico

28 shkurt - 2 mars 2010, Tarrytown, New York

Forumi tregditor për Filantropinë në Ballkanin Perëndimor solli së bashku liderë të filantropisë nga regjioni për të shtjelluar tema të rëndësishme të bashkëpunimit, qëndrueshmërisë dhe integritetit regional të Ballkanit Perëndimor. Diskutimet janë përqëndruar në identifikimin e gjendjes së tanishme të filantropisë në regjion; ndarja e përvojave më të mira; ndihma për të formuluar strategjitë e duhuara për rritje të fondeve në vendet e regjionit, si dhe fushat e bashkëpunimit ndër-kufitar. Panelistët e sesioneve ishin filantropistë, profesionistë, si dhe përfaqësues të filantropisë korporative nga sektori privat i SHBA-ve, Global Fund for Community Foundations, organizatat partnere nga Ballkani Perëndimor dhe RBF. Ndërsa, pjesëmarrësit në forum ishin përfaqësues të fondacioneve, fitues të çmimeve për Filantropinë Korporative, donatorë individual, gazetarë, si dhe organizata joqeveritare nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

FIQ në media



Siguria e brishtë në Kosovë

Publikuar: 6 enjte, më 10 tetor 2010

Prishtinë, 15 tetor -

Institucionet kosovare të sigurisë nuk kanë zhvilluar kapacitete të nevojshme për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës. Institucionet e sigurisë nuk kanë gatishmëri dhe mungon një vizion i duhur për marrjen e përgjegjësisë në sektorin e sigurisë nga prania ndërkombëtare.

Këto janë disa nga gjetjet e raportit të fundit të publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe

Forumit për Iniciativa Qytetare, ka raportuar Radio Evropa e Lirë.

Me këtë rast është organizuar edhe një debat me temën "Sektorin e sigurisë në



Prishtinë, 31 maj 2011 – Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) ka organizuar tryezën e radhës sot në ambientet e "Hotel Prishtina", në Prishtinë. Tema që u shqjellua në këtë tryezë ishte "Zbatimi i politikave kundër narkotikëve ilegal".

hulumtimin (një studim kualitativ), realizuar nga FIQ në bashkëpunim me organizatat partnere, hulumtim ky i cili ka për qëllim të vlerësojë veprimet e qeverisë



OPINION I PAVARUR I AUDITORËVE

Për menaxhmentin e Forumit për Iniciativa Qytetare

Ne i kemi audituar deklaratat financiare, të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore të Forumit për Iniciativa Qytetare në Prishtinë, Kosovë, për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2010 të shprehura në EURO. Këto deklarata financiare dhe të dhënat financiare shtesë janë përgjegjësi e menaxhmentit të organizatës. Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion në lidhje me informatat financiare të përmendura më lartë, bazuar në auditimin tonë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Me këto standarde kërkohet që ne ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë garanci të arsyeshme për atë se a janë formularët e raportimit pa deklarime të gabuara materiale. Auditimi përfshinë ekzaminimin bazuar në test të dëshmisë për të mbështetur shumat dhe publikimet në formularët e raportimit. Në auditim hyn edhe vlerësimi i parimeve të kontabilitetit që përdoren dhe vlerësimet e përafërta të konsiderueshme nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e llogaritjet dhe raportimin e rregullt të të dhënave në lidhje me deklaratat financiare. Ne besojmë se sipas mendimit tonë, auditimi ynë paraqet bazë të arsyeshme.

Sipas opinionit tonë, informatat financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2010, e prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Forumit për Iniciativa Qytetare, ndërsa rezultatet e operacioneve janë në përputhje me marrëveshjet kontraktuese të nënshkruara me donatorët dhe ligjet përkatëse të Kosovës.

Lulzim Zeka
Auditor i autorizuar
BU & Partners
Prishtinë

STAFI

Ferdinand Nikolla, Drejtor Ekzekutiv

Nazim Haliti, Menaxher i Programit

Nita Luzha, Menaxhere e Programit

Valdrin Grainca, Menaxher i Projektit

Sefë Govori, Menaxher i Financave

Arieta Rexhepi, Zyrtare për Komunikim

Amire Rafuna Gashi, Zyrtare për Administratë

Florentina Hajdari, Asistente e Hulumtimeve

RAPORT VJETOR

2010



Forum për Iniciativë Qytetare

tel.+381(0)38 248 677

Rr. Rexhep Mala 5/A

10000 Prishtinë, Kosovë

www.fiq-fci.org

www.safeplaceproject.org

www.forumipersiguri.org